



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

**“PËR  
MIRATIMIN E KATEGORIVE, KUSHTEVE, KËRKESAVE TË KUALIFIKIMIT  
DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR LIÇENCIMIN E AUDITUESIT  
ENERGJETIK DHE PËR SHËRBIME ENERGJETIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 124/2015, “Për Eficiência e Energjisë”, dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 6/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për liçencimin e audituesit energjetik dhe për shërbime energjetike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Vendimi
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI**

# KATEGORITË, KUSHTET, KËRKESAT E KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR PAJISJEN ME LIÇENCË TË AUDITUESIT ENERGJETIK DHE PËR SHËRBIME ENERGJETIKE

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Objekti dhe fusha e veprimit.

Ky Vendim ka për objekt dhe shtrin fushën e veprimit në:

1. Përcaktimin e kategorive, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit e të eksperiencës profesionale të audituesit energjetik dhe për shoqëritë e shërbimeve energjetike;
2. Përcaktimin e kushteve për pajisjen me certifikaten e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe/ose në instalime industriale dhe/ose në transport.

#### Neni 2

#### Përkufizimi i termave

Të gjithë termat e përcaktuara dhe që rrjedhin nga:

1. Ligji Nr. 10081/2009, "Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë";
2. Ligji Nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë";
3. Ligji Nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë në ndërtesa";
4. Ligji Nr. 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji";
5. Ligji Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme";
6. Ligji Nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar;

së bashku me ndryshimet e ardhshme që mund të pësojnë këto ligje, kanë dhe do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë Vendim, ndërsa kuptimi i termave të mëposhtëm do të jetë:

- a) "**Licencë profesionale për auditimin e energjisë**" është akti administrativ që i njëjtit titullar të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë veprimtarinë e audituesit të energjisë në ndërtesa, instalime industriale dhe në transport.
- b) "**Licencë profesionale për shërbime energjetike**" është akti administrativ që i njëjtit titullar të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë veprimtarinë për shërbime energjetike në ndërtesa, instalime industriale dhe në transport.
- c) "**Vite eksperiencë**" janë vite pune gjithsej të dokumentuara me librezë pune dhe/ose çdo dokument tjetër të barazvlefshëm me të, nga momenti i përfundimit të studimeve të masterit shkencor dhe/ose profesional, si edhe pas **certifikimit** në një nga kurset e formimit të vazhduar pasuniversitar, në fushën e auditimit të energjisë.

- d) **“Subjekt”** çdo person fizik apo person juridik i regjistruar ~~paraprakisht~~ në regjistrin tregtar (pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit) dhe që mund të pajiset me liçencë në përputhje me legjislacionin në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e auditimit të energjisë.
- e) **“Diplomë”** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë.
- f) **“Çertifikatën e Audituesit Energjetik”** e lëshuar nga Agjencia e Eficencës së Energjisë, që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa, instalime industriale dhe transport.
- g) **“Kushte dhe kërkesa të liçencimit”** janë ato kushte, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave, nga mbajtësi i Liçencës, është e detyrueshme.
- h) **“Sekretariati Teknik i Komisionit”** - është struktura pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë, që kryen procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit, relatimit dhe regjistrimit të individëve dhe personave juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e auditimit të energjisë.

## KREU II

### FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE PËR AUDITUESIT ENERGETIK DHE PËR SHËRBIMET ENERGETIKE

#### Neni 3

##### Krijimi dhe përbërja e Komisionit të Posaçëm të Liçencimit

1. Komisioni Posaçëm i Liçencimit (këtëj e tutje Komisioni) pranë Ministrisë përgjegjëse për energjinë, ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me këtë vendim dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë.
  - tre anëtarë nga Agjencia për Eficencën e Energjisë
  - dy anëtarë nga Ministria përgjegjëse për energjinë
3. Komisioni merr vendime për dhënie licence profesionale individuale dhe për shoqëri, shtesa dhe rinovime në licencat profesionale, ndryshime të drejtuesve të shoqërisë dhe marrjen e masave administrative, mbështetur kryesisht në kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

#### Neni 4

##### Liçencimi

1. Komisioni thirret në mbledhje nga Kryetari i tij.
  - Si rregull, ai mblidhet çdo muaj, ndërmjet datave 25 – 30.
  - Me kërkesë të Kryetarit të Komisionit mblidhet dhe jashtë radhe.
2. Në mbledhjen e tij të parë, Komisioni zgjedh Nënkryetarin e tij.
3. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në mungesë të Kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga Nënkryetari i Komisionit.

4. Në mbledhje, Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet e paraqitura nga Sekretariati Teknik, të cilat janë depozituar, të paktën 4 ditë, para datës së mbledhjes.
5. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll. Protokollit mbahet nga një përfaqësues i Sekretariatit Teknik të Komisionit. Protokollit mbahet në një libër të veçantë protokollit, të sekretuar me numër faqesh dhe përmban të dhëna, të paktën, për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve.
6. Kryetari i Komisionit vendos pa trajtuar në komision për praktikën e përgatitja nga Sekretariati Teknik, që lidhen me kërkesa të subjekteve të karakterit formal, si vijon;
  - Ndryshim dhe shtesë në përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë;
  - Ndryshim emërtim shoqërie;
  - Ndryshimi i selisë së shoqërisë;
  - Lëshimi i dublikatës;
  - Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrim i tyre.

## **Neni 5**

### **Përgatitja e materialeve për Komision**

1. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës të Komisionit hartohet nga Sekretariati Teknik dhe miratohet nga Kryetari i Komisionit.
2. Komisioni shqyrton materiale, që kanë të bëjnë me licencimin e individëve apo shoqërive, ankesa të tyre për vendimet pararendëse, informacione e kërkesa të personave juridikë publik apo privat, përfundime dhe raporte nga kontrollet e kryera.
3. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati Teknik, jo më vonë se tre ditë para ditës së caktuar për mbledhje.
4. Materialet përgatiten nga Sekretariati Teknik dhe nënshkruhen nga drejtuesi respektiv dhe përpunuesit e tij.

## **Neni 6**

### **Ekspertët**

1. Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, caktohen ekspertë. Çdo grup ekspertësh drejtohet nga një anëtar Komisioni.
2. Ekspertët përzgjidhen nga drejtori i strukturës përgjegjëse për licencimin pranë Ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe/ose Agjencisë së Eficencës së Energjisë,
3. Ekspertiza e përgatitur me shkrim i dorëzohet Komisionit, nëpërmjet Sekretariatit Teknik.

## **Neni 7**

### **Afati i marrjes dhe hartimi vendimeve**

1. Komisioni merr vendim jo më vonë se 35 ditë kalendarike, nga momenti i aplikimit me dokumentacion të plotë.

2. Vendimet në Komision, si rregull, merren me konsensus. Kur konsensusi nuk arrihet, vendimi merret me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të komisionit. Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.
3. Vendimet e Komisionit hartohen nën përgjegjësinë e Sekretariatit Teknik, dhe nënshkruhen nga Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.
4. Vendimet e Komisionit përgatiten në tre kopje: njëra dorëzohet në zyrën e arkiv dokumentacionit të Agjencisë së Eficencës së Energjisë, tjetra në Sekretariatit Teknik, për veprime të mëtejshme, dhe e treta në praktikën e Komisionit, që disponohet nga Kryetari i Komisionit.

## **Neni 8**

### **Sekretariati teknik**

Sekretariati Teknik i Komisionit organizohet dhe funksionon pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë. Organizimi i Sekretariatit bëhet në bazë e zbatim të strukturës organizative dhe veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të Agjencisë së Eficencës së Energjisë dhe këtë Vendim.

## **Neni 9**

### **Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave**

1. Kërkesa për licencë, si dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas këtij Vendimi, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën IV.4 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe” të shtojcës bashkelidhur Ligjit Nr. 6/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.
2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë:
  - a) origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit;
  - b) në gjuhën shqipe, ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë;
  - c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre, si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën IV.4 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe”, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili disponohet në listën e publikuar të dokumentacionit të kërkuar. Tarifat për individë dhe personat juridikë, vendas e të huaj, që licencohen, janë sipas Shtojcës I, të këtij vendimi.
4. Sekretariatit Teknik regjistron menjëherë në protokollin e aplikimeve kërkesat e regjistruara elektronikisht dhe përgatit kartelën shoqëruese të aplikimit.
5. Në kartelën shoqëruese evidentohen shënime, në lidhje me përputhshmërinë e dokumentacionit të aplikimit, me kërkesat e këtij Vendimi. Kartela shoqërohet detyrimisht

me mendimin e motivuar e të nënshkruar të specialistit dhe përgjegjësit të sektorit. Mendimi i Sekretariatit, në materialin që i paraqitet Komisionit, bazohet në këtë kartelë.

6. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve, pranë Sekretariatit Teknik, do të kryhet vetëm në këto raste:
  - a) Për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga aplikuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;
  - b) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë Vendim;
  - c) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/ dokumenteve nga Sekretariati Teknik;
  - d) Kur kërkohet verifikim nga Komisioni.
7. Çdo dokumentacion aplikimi apo plotësime të tij, shqyrtohet brenda 3 ditë pune, nëse përmban ose jo, të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës, sipas këtij Vendimi, duke njoftuar aplikuesin, nëpërmjet sistemit informatik.

## **Neni 10**

### **Verifikimi i dokumentacionit**

1. Verifikimi i deklarimeve apo dokumenteve të subjekteve aplikuese kryhet në bazë të informacioneve që disponohen nga subjekte juridikë publik apo privat, ose me përzgjedhje nga Sekretariati Teknik, pranë institucioneve kompetente.
2. Procedurat dhe afatet e verifikimit nuk pengojnë procesin e licencimit të subjekteve.
3. Në rastet e konstatimit të deklarimeve apo dokumenteve të rreme, atëherë Sekretariati Teknik raporton këtë fakt pranë Komisionit dhe propozon masat konkrete, në përputhje me nenin 27 të këtij Vendimi.

## **Neni 11**

### **Ruajtja dhe arkivimi**

1. Sekretariati Teknik, mbi bazën e vendimit të Komisionit, përgatit formularët e licencave në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave, pas nënshkrimit nga Kryetari, i dorëzohet subjektit përkatës, e vulosur, ndërsa tjetra, e nënshkruar edhe nga hartuesit, ruhet për arkivim.
2. Licencat profesionale janë dokumente me vlerë, që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë. Format i tyre miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për Energjinë me propozim të Agjencisë për Eficencën e Energjisë.
3. Sekretariati Teknik përgjigjet për arkivimin, sipas rregullave në fuqi, të licencës dhe kartelës shoqëruese të aplikimit.
4. Arkivimi i këtij dokumentacioni organizohet, sipas rregullave të brendshme të Agjencisë së Eficencës së Energjisë, në ambient të veçantë.

## **Neni 12**

### **Bashkëpunimi me persona juridik publik apo privat**

1. Sekretariati Teknik, nëpërmjet strukturës organizative të Agjencisë për Eficencën e Energjisë, mban lidhje të qëndrueshme me institucionet e administratës shtetërore. Ai:
  - a) kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij;
  - b) trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave apo propozimeve të tyre;
  - c) kërkon me shkresë zyrtare, verifikimin e saktësisë së vetëdeklarimeve të aplikuesve, apo vërtetësisë së dokumenteve të lëshuara nga institucionet, e të paraqitura nga subjektet në procedurat e aplikimit.
2. Sekretariati Teknik ka për detyrë të informojë çdo kërkues, në lidhje me:
  - a) kërkesat e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për të aplikuar për licencë;
  - b) përputhshmërinë e dokumentacionit në lidhje me kërkesat e këtij vendimi;
  - c) ecurinë e aplikimit të tij për licencë;
  - d) të dhëna në lidhje me individë, apo shoqëri të licencuara, për rastet kur kërkuesi vërteton se është i përfshirë në procese ligjore, me subjektin, për të cilin kërkon informacion.
3. Sekretariati Teknik, si rrjedhim i kërkesës së Komisionit, apo i procesit të përzgjedhjes të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve/ dokumenteve, kërkon me shkresë zyrtare, pranë subjekteve private, informacione në lidhje me vërtetësinë e:
  - a) referencave të lëshuara nga subjekti privat, të paraqitura nga aplikuesi.
  - b) projekteve të hartuara nga subjekte udhëheqës të këtyre projekteve, e të paraqitura nga aplikuesi, si bashkëpjesëmarrës në hartimin e tyre.

### **Neni 13**

#### **Veprime të drejtpërdrejta nga Sekretariati Teknik pa pasur nevojë për t'u trajtuar me mbledhje në Komision**

1. Sekretariati Teknik ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në trajtimin nga Komisioni, për rastet e parashikuara në nenin 4, pika 6 të këtij vendimi, mbështetur në dokumentacionin përkatës të paraqitur, në zbatim të këtij vendimi.
2. Për çdo rast të tillë paraqitet kërkesa, nëpërmjet sistemit informatik të integruar dhe veprohet sipas nenit 9 të këtij vendimi.
3. Vlerësimi i dokumentacionit, të paraqitur sipas pikës 1, shoqërohet me procesverbal të hartuar nga Sekretariati Teknik, i cili së bashku me licencat respektive, që pasqyrojnë ndryshimin (për rastet kur nevojitet licencë e ndryshuar), i dërgohen për nënshkrim Kryetarit të Komisionit. Ndryshimet reflektohen menjëherë në regjistrat profesionale të subjekteve të licencuara. Sekretariati Teknik bën të pavlefshme licencën profesionale origjinale, që subjekti dispononte përpara ndryshimit.

### **KREU III**

## **KATEGORIA (NËNKATEGORIA) PËR LIÇENCËN E AUDITUESIT ENERGJETIK DHE PËR SHËRBIMET ENERGJETIKE, TË DREJTAT DHE DETYRAT E SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN SI EDHE SPECIFIKIMET PËRKATËSE PËR LIÇENCËN**

### **Neni 14**

#### **Nënkategoria e Liçencës së audituesit energjetik dhe shërbimeve energjetike**

Në bazë të parashikimeve të pikës 4, Fusha IV.4 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe”, të shtojcës së ligjit Nr. 6/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Liçenca për audituesit energjetik dhe shoqëritë e shërbimeve energjetike lëshohet për nënkategoritë:

- a. “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në ndërtesa”;
- b. “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në instalime industriale”;
- c. “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në transport”;
- d. “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me shërbimet energjetike”.

### **Neni 15**

#### **E drejta për pajisje me licencë pranë Agjencisë së Eficencës së Energjisë**

1. Çdo individ apo shoqëri, vendas ose i huaj, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e auditimit energjetik dhe shërbimet energjetike, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të dhënies së licencave profesionale në Agjencinë për Eficencën e Energjisë, për t’u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë vendim.
2. Licencimi i nënkategorive të parashikuara në nenin 3 të këtij vendimi, bëhet në përputhje me nenin 3 dhe pikën 4 të Fushës IV të shtojcës së Ligjit Nr. 6/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

### **Neni 16**

#### **Detyrat e subjekteve të licencuara**

1. Detyrat e subjekteve të licencuara, janë:
  - a) Të njohin dhe të kryejnë veprimtari, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë fushën e auditimit energjetik dhe shërbimet energjetike.
  - b) Të njohin e të zbatojnë standardet, kushtet teknike të projektimit, si dhe normat e standardet europiane të pranuar nga vendi ynë.



- c) Çdo subjekt i licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të drejtuesit/drejtuesve teknikë.
- d) Subjekti duhet të ketë statusin “aktiv” të ushtrimit të veprimtarisë, dëshmuar me dokumentin respektiv (ekstrakti historik apo ekstrakti për të dhënat e subjektit), të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.
- e) Drejtuesi teknik i shoqërisë detyrohet të njoftojë një muaj më parë, zyrtarisht, me kërkesë të motivuar, përfaqësuesin ligjor për largimin nga shoqëria. Njëkohësisht, duhet të paraqesë pranë Komisionit, kërkesën/deklaratën për prishjen e kontratës, të hartuar në prani të noterit, ose dokumentin zyrtar, të lëshuar nga shoqëria për këtë largim.
- f) Çdo largim, pa respektuar procedurat e pikës “e” të këtij neni, shoqërohet me marrjen e masës administrative kundrejt individit.
- g) Çdo ushtrim veprimtarie nga shoqëria, pa drejtues teknik, shoqërohet me masë administrative kundrejt shoqërisë, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij vendimi.

## **Neni 17**

### **Elementët e licencës dhe kufizime**

1. Licenca përmban këta elemente:
  - a) Të dhëna të individit apo shoqërisë disponuese;
  - b) Titullin e diplomës së individit dhe vitin e diplomimit, për licencat individuale.
  - c) Datën e regjistrimit në regjistrat profesional përkatës.
  - d) ç) Kategoritë për veprimtaritë që ka të drejtë të ushtrojë disponuesi;
  - e) Afati i vlefshmërisë për rastet e shoqërive;
  - f) dh) Numrin unik të licencës profesionale;
  - g) Shenja dalluese;
  - h) Fotografia e individit për licencat individuale;
  - i) Kategoritë e plota në fushën auditimit energjitik dhe shërbimet energjitike, në pjesën e prapme të formularit të licencës.

## **Neni 18**

### **Kufizime për tërheqjen dhe përdorimin e licencave**

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo trashëgohet, nga një individ apo shoqëri tek tjetra.
2. Kur një individ apo shoqëri humbet licencën profesionale, njofton menjëherë, zyrtarisht, Sekretariatit Teknik.
3. Licencat individuale tërhiqen nga vetë personi i licencuar, ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).
4. Licencat e shoqërive tërhiqen nga përfaqësuesi ligjor, ose persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet), ose nga drejtuesit teknikë të shoqërisë.

5. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re, si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknikë, përfaqësuesve ligjorë, apo ndryshim të emrit apo selisë, përpara se të tërheqin licencën, duhet të dorëzojnë origjinalin e licencës paraardhëse. Origjinali shënjohehet nga Sekretariati Teknik me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit, pranë arkivës së Sekretariatit.

## **Neni 19**

### **Kufizime në dhënien e licencave**

Nuk lejohet të pajisen me licencë, në rolin e drejtuesit teknik për shoqëri, personat që punojnë në institucionet shtetërore qendrore, vendore, apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil.

## **Neni 20**

### **Afatet e vlefshmërisë së Licencës**

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave, nga data e lëshimit të tyre, janë:
  - a) për licencë profesionale të shoqërive lidhur me auditimin energjistik për ndërtesa, instalime industriale, transport dhe shërbime energjetike, sa afati i vlefshmërisë së kontratës, që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknikë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të shkurtër), por jo më shumë se 7 vjet.
  - b) licencat individuale jepen me afat të përhershëm, me kusht rinovimin çdo 7 vjet të çertifikatës së audituesit energjetik sipas kërkesave të këtij vendimi.

## **KREU IV**

### **KUSHTET, KËRKESAT E KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE TË KËRKUAR, PËR T'U PAJISJUR ME LIÇENCËN E AUDITUESIT ENERJETIK DHE PËR SHËRBIMET ENERJETIKE**

## **Neni 21**

### **Kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale të kërkuar, për t'u pajisjur me licencë sipas nënkategorive**

1. **Personat fizik dhe juridik** liçensohen si auditues energjetik, në përputhje me parashikimet e Kreut II të këtij Vendimi, nëse plotësojnë kriteret e posaçme:
  - a. Çertifikatën e Audituesit Energjetik të lëshuar nga Agjensia e Efiçencës së Energjisë ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për energjinë, për testimin e njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe/ose në instalime industriale dhe/ose në transport, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij vendimi;

- b. Vërtetime dhe /ose librezë pune të individit mbi bazën e së cilave provohet që ka të paktën 5 vite eksperiencë pune në institucione publike dhe /ose shoqëri private që operojnë në fushën e energjisë, shoqëri studimi, projektimi e zbatimi, ose institucionet e arsimit të lartë sipas degëve të referuara në nenin 22 të këtij vendimi;
2. **Personat juridik** liçensohen si **shoqëri të shërbimeve energjetike**, në përputhje me parashikimet e kreut II të këtij Vendimi, nëse plotësojnë kriteret e posaçme:
- a. Çertifikatë për Drejtuesin Teknik;
- c. Çertifikatën e Audituesit Energjetik të lëshuar nga Agjensia e Efiçencës së Energjisë/ ose deri në krijimin e saj, nga Ministria përgjegjëse për energjinë, për testimin e njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe/ose në instalime industriale dhe/ose në transport, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij vendimi;
- b. Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës të cilat duhet të jenë me afat mbi 1 vit;
- c. Vërtetime dhe /ose librezë pune të Drejtuesit Teknik mbi bazën e së cilave provohet që ka të paktën 5 vite eksperiencë pune në institucione publike dhe /ose shoqëri private që operojnë në fushën e energjisë, shoqëri studimi, projektimi e zbatimi, ose institucionet e arsimit të lartë sipas degëve të referuara në pikën 2 të nenit 23 të këtij vendimi;.

## KREU V

### ÇERTIFIKATA DHE TESTIMI KOMBËTAR PËR AUDITUESIT ENERJJETIKË

#### Neni 22

#### Çertifikata e audituesve energjetik

1. Për qëllime të liçencimit të audituesve energjetik, AEE i lëshon personit që ka kaluar testimin kombëtar, Çertifikatën e Audituesit Energjetik sipas formatit të përcaktuar në shtojcën II, të këtij vendimi;
2. Çdo Auditues Energjetik i pajisur me Çertifikatën e Audituesit Energjetik, ka të drejtën të përcaktohet ose emërohet si menaxher i energjisë nga konsumatori i madh i energjisë, në përputhje me kërkesën e pikës 1 të nenit 10 të ligjit Nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë”;
3. Kërkesat dhe kushtet mbi vlefshmërinë, rinovimin dhe revokimin e çertifikatës së Audituesit Energjetik janë të njëjta me ato të parashikuara në Kreun që rregullon çertifikimin e Menaxherëve të Energjisë të Vendimit që miraton kategoritë, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë;

#### Neni 23

#### Testimi kombëtar për Audituesit Energjetik

1. Për qëllime të çertifikimit të Audituesit Energjetik, AEE organizon kryerjen e testimit kombëtar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashikuara për **aplikimin dhe pranimin**

- për Testimin Kombëtar të Audituesit të Energjisë, sipas Vendimit që miraton kategoritë, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për audituesin energjetik;
2. Të drejtën për t'u paraqitur në testimin kombëtar, e kanë vetëm kandidatët që paraqesin pranë AEE, dokumentacionin e mëposhtëm:
    - a) Diplomën e nivelit “master i shkencave” ose “master profesional”, në arsimin e lartë në: Inxhinieri Mekanike; Inxhinieri Elektrike; Inxhinieri Fizike; Inxhinieri Elektronike; Arkitekturë dhe Urbanistikë; Inxhinieri Ndërtimi (Profili Ndërtim dhe Administrim); Inxhinieri Mjedisi (Profili Energjitikë), në shkencat e fizikës dhe kimisë industriale dhe Inxhinieri ekonomike dhe/ose **dy vjet** eksperiencë pune, që përfshin përdorimin energjisë në operacione, mirëmbajtje, planifikim, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë shqiptar apo diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, të njësuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin dhe Sportin.
    - b) Çertifikatë të lëshuar nga institucionet arsimore private dhe/ose publike që provojnë ndjekjen e kurseve të formimit të vazhduar pasuniversitar, në fushën e auditimit të energjisë, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
    - c) Dokument identifikimi.
  3. Një kandidat do të deklarohet se ka kaluar testimin kombëtar për Audituesin Energjetik nëse ka siguruar me shume se një minimum prej 50% të pikëve maksimale për secilin nga modulet I, II, III dhe IV të mëposhtëm:
    - a) Moduli-I: Aspekte të përgjithëshme të Menaxhimit dhe Auditimit të energjisë
    - b) Moduli-II: Efiçienca e energjisë në shërbimet/pajisjet termike
    - c) Moduli-III: Efiçienca e energjisë në shërbimet/pajisjet elektrike
    - d) Moduli-IV: Auditimi i Energjisë në ndërtesa dhe industriPërmbajtja e katër moduleve të testimit I, II, III dhe IV përcaktohet në shtojcën IV të këtij vendimi.
  4. Kalimi me sukses i testimit dhe marrja e çertifikatës përkatëse është kusht i detyrueshëm për t'u pajisur me liçencën e audituesit të energjisë, sipas parashikimeve të Kreut IV të këtij Vendimi.
  5. Kandidatët që nuk kalojnë testimin kombëtar, lejohen të ripërsëritin testimin deri në pesë herë, brenda 6 (gjashtë) testeve kombëtare të njëpasnjëshme, me një pagesë suplementare prej 2000 lekë për cdo modul;

## **KREU VI REGJISTRAT PROFESIONALË DHE ARKIVI**

### **Neni 24**

#### **Regjistrimi i licencave profesionale**

1. Të dhënat e licencave profesionale që miratohen nga Komisioni, regjistrohen në Regjistrat Themeltarë të licencave profesionale individuale dhe të shoqërive.
2. Regjistrat janë dokumente elektronikë, në përgjegjësi të Sekretariatit Teknik, ku regjistrohen të dhënat e licencimit të subjekteve, sa herë ato trajtohen dhe u miratohet licencimi, me të paktën parametrat:
  - a) Emërtimi i subjektit të licencuar,
  - b) Numri i licencës.
  - c) Qyteti ku subjekti është rezident

- d) Emri i drejtuesit ligjor në rastin e shoqërive
3. Sekretariati Teknik është përgjegjës për hartimin, përditësimin dhe publikimin në faqen zyrtare elektronike të Agjencisë për Eficencën e Energjisë të:
- a) Regjistrin profesional për licencat profesionale individuale “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në ndërtesa”;
  - b) Regjistrin profesional për licencat profesionale të shoqërive për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në ndërtesa”;
  - c) Regjistrin profesional për licencat profesionale individuale për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në instalime industriale”;
  - d) Regjistrin profesional për licencat profesionale të shoqërive për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në instalime industriale”;
  - e) Regjistrin profesional për licencat profesionale individuale për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në transport”;
  - f) Regjistrin profesional për licencat profesionale të shoqërive për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në transport”;
4. Të dhënat përditësohen, në përputhje me ndryshimet që licencat pësojnë, si rezultat i aplikimeve, miratimeve apo penalteteve;
5. Regjistrat janë dokumente publikë, të cilat, në përgjegjësinë e Sekretariatit Teknik, publikohen në faqen zyrtare të AEE dhe të Ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe u mundësohet aksesimi në to, çdo enti publik apo privat.
6. Arkivi i dokumentacionit të aplikimeve dhe licencave të miratuara, organizohet nga Sekretariati Teknik, sipas përcaktimeve në ligjin për arkivat, bashkë ose veças nga arkivi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë, në bazë të Urdhrit të veçantë të Titullarit.

## **Neni 25**

### **Regjistri i çertifikatave të audituesve energjetikë**

Agjencia e Eficencës së Energjisë është përgjegjëse për hartimin, përditësimin dhe publikimin në faqen zyrtare elektronike të saj të regjistrin të çertifikatave të Audituesve Energjetik, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën III të këtij vendimi;

## **KREU VII**

### **SANKSIONE DHE DIZPOZITA KALIMTARE**

## **Neni 26**

### **Masa disiplinore ndaj subjekteve të licencuara**

1. Heqja e të drejtës për ushtrimin e aktivitetit, apo pezullim të përkohshëm të Liçencës së audituesit energjetik, si për individë apo shoqëri, bëhet nga Komisioni, në këto raste kur:

- a. Konstatohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë Vendim) të rreme, apo dokumente të pavërteta.
- b. Kryen veprimtari pa drejtues teknik/Nuk plotëson detyrimet dhe kufizimet, që rrjedhin nga ky vendim;
- c. Drejtuesi teknik largohet pa arsye nga shoqëria;
- d. Ka propozime të motivuara nga institucione shtetërore, për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim.

Për çdo rast, nga Sekretariati Teknik, ose grup ekspertësh, hartohet raport vlerësimi dhe shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

2. Masa për shoqëritë, drejtuesit teknikë dhe individët e licencuar, sipas shkeljeve të bëra gjatë ushtrimit të veprimtarisë, janë me heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për: 6 muaj, 1 vit, 2 vjet, 3 vjet ose përgjithmonë, tërësisht ose pjesërisht për klasat dhe kategoritë që disponon në licencë.
3. Për masat e vendosura nga Komisioni, njoftohet brenda një dite, subjekti ndaj të cilit është vendosur masa dhe struktura përgjegjëse për inspektimin në këtë fushë. Për rastet e deklarimeve të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen edhe me kallëzim në organet kompetente.
4. Liçencat revokohen nga Ministri përgjegjës për Energjinë, me iniciativën e tij ose me propozim të Agjencisë së Eficencës së Energjisë, në përputhje me parashikimet pikës 5 të nenit 17 të Ligjit Nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”.

## **Neni 27**

### **Ankimi**

1. Për çdo vendim të Komisionit, individët apo përfaqësuesit e shoqërive, kanë të drejtën e ankimit tek Ministri i përgjegjës për fushën e energjise, brenda 30 ditëve, nga data e njoftimit apo publikimit.
2. Titullari i Ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 15 ditëve:
  - a) Lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni.
  - b) Kthimin për rishqyrtim, në Komision, të vendimit të marrë.
  - c) Anullimin e vendimit të marrë.

## **Neni 29**

### **Dispozita të fundit**

Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## Shtojca I

### TARIFA

Për personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj që pajisen me Licencë profesionale zbatohen këto tarifa:

“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në ndërtesa”;	1,000 lekë
“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në instalime industriale”;	1,000 lekë
“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me auditimin energjetik në transport”;	1,000 lekë
“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me shërbimet energjetike”.	1,000 lekë

## SHTOJCA II


### FORMATI I ÇERTIFIKATËS SË TESTIMIT TË AUDITUESIT ENERGJETIK

AGJENCIA PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË

Numri i regjistrimit për testim: \_\_\_\_\_ Numri i serisë \_\_\_\_\_

Numri i çertifikatës së regjistruar \_\_\_\_\_

#### ÇERTIFIKATË PËR AUDITUESIN ENERGJETIK



Vërtetohet se Z/Znj/Zj \_\_\_\_\_

Biri/Bija i/e \_\_\_\_\_ që ka kaluar Testimin Kombëtar për Audituesin Energjetik, në datë \_\_\_\_\_, kualifikohet si Auditues Energjetik i Çertifikuar.

Kjo çertifikatë është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të çertifikatës dhe do të jetë subjekt i rinovimit, duke iu nënshtruar ndjekjes së kursit afatshkurtër të përditësimit të njohurive, një herë në çdo pesë vjet.

Emri i Tij/Saj është regjistruar në regjistrin e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë për audituesit e çertifikuar të energjisë me numër serie \_\_\_\_\_.

Lëshuar në datë \_\_\_\_\_ nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë.

(Firma dhe Vula)

**Drejtori**

**Agjencia për Efiçencën e Energjisë**



**SHTOJCA III**

**FORMATI I REGJISTRIT TË ÇERTIFIKATAVE TË AUDITUESVE ENERGETIK**

_____ (DD/MM/20YY)			
<b>A.</b>	<b>Informacion mbi çertifikatën</b>		
1.	Emri i audituesit energjetik		<b>Fotografia</b>
2.	Emri i babait		
3.	Numri i regjistrimit për testim		
4.	Numri i çertifikatës së regjistruar		
5.	Data e hyrjes në regjistër		
6.	Data e lëshimit të çertifikatës		
7.	Data e rinovimit të çertifikatës	1.	
		2.	
		3.	

<b>B.</b>	<b>Të dhënat e komunikimit</b>	
1.	Adresa postare	
2.	Adresa e E-mail	
3.	Numra të telefonit.	

<b>C</b>	<b>Përvoja e punës për përmbushjen e kritereve të kualifikimit</b>						
	Nga		Në		Përshkrim i shkurtër i experience së punës		
	<i>Muaji</i>	<i>Viti</i>	<i>Muaji</i>	<i>Viti</i>	<i>Emri dhe adresa e punëdhënësit</i>	<i>I vetepunësuar</i>	<i>Përmbajtja e punës/eksperienca</i>
1.							
2.							
3.							
4.							

<b>D</b>	<b>Informacion personal</b>		
1.	Data e lindjes	DD/MM/YY	
2.	Kombësia		
3.	Edukimi arsimor		
	<i>Diploma/kualifikime</i>	<i>Institucioni/Universiteti</i>	<i>Viti</i>
1.	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____
1.	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____

<b>E</b>	<b>Shenime</b>

## SHTOJCA IV

### MODULI-I: ASPEKTE TË PËRGJITHËSHME TË MENAXHIMIT DHE AUDITIMIT TË ENERGJISË

#### A. Energjia dhe Skenarët e Energjisë

1. Hyrje në format e Energjisë
  - Puna, Energjia dhe Fuqia
  - Bazat e prodhimit të Energjisë Elektrike
  - Bazat e Energjisë Termike
  - Njësitë e Energjisë dhe Konvertimet
2. Llojet e energjise dhe burimet energjetike
  - Energjia Primare dhe Sekondare
  - Energjia e Trgetueshme dhe energjia jo e tregetueshme
  - Energjia e Rinovueshme dhe ajo Fosile
  - Rezervat Globale të Energjisë dhe Prodhimi i Energjisë për qëllime tregëtimi
3. Konsumi Fundor i Energjisë
  - Tarifat e Energjise në Shqipëri, Enti Rregullator dhe tarifat e rregulluara
  - Bilanci i prodhimit dhe konsumit të Energjisë në Shqipëri
  - Konsumi i energjisë sipas sektoreve kryesore të ekonomisë në Shqipëri
  - Nevojat energjitike të Ekonomisë në Zhvillim dhe Shqipëria
  - Intensiteti i Energjisë
4. Politikat e Integruara të Energjisë
  - Skenarët afatgjatë të Energjisë për Shqipërisë, Strategjia e Energjise
  - Siguria Energjitike
  - Eficenca dhe Kursimi i Energjisë. Rëndësia e reduktimit të Gazeve me efekt sërre (GHG)

#### B. Legjislatiioni i Energjisë dhe Eficencës së Energjisë

1. Ligji Nr. 43, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;
  - Tregu i rregulluar dhe liberalizimi i sektorit të energjise
  - Operatoret e tregut të energjise
  - Ndarja e kompanive shtetërore të prodhimit/transmetimit/shpërndarjes
  - Enti rregullator i energjise elektrike, roli dhe mbrojtja e konsumatorit
  - Politike-berja dhe roli i ministrise përgjegjëse të energjise
2. Ligji Nr.102, datë 23.09.2015 "Për sektorin e gazit natyror";
  - Operatoret e tregut
  - Albgaz
  - Transmetimi dhe shpërndarja, projekti TAP
3. Ligji Nr.124, datë 12.11.2015 "Për Eficencën e Energjisë";
  - Plani Kombëtar i Veprimit të Eficencës së energjise, objektivat kombëtare
  - Institucionet përgjegjëse për Eficencën, Detyrat dhe Funksiionet
  - Audituesit dhe Menaxheret e energjise, roli dhe përgjegjësite.
  - Agjencia për Eficencën e Energjise, roli, detyrat dhe përgjegjësite
  - Fondi për Eficencën e Energjise, statusi dhe roli.
  - Kompanitë e shërbimeve energjetike
4. Ligji Nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme";
  - Plani Kombëtar i Veprimit për nxitjen e burimeve të rinovueshme të energjise, objektivat kombëtare
  - Agjencia përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë

- Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Tarifat nxitese dhe kontratat per diference. Operatori i BRE.
  - Aksesit dhe kostot per lidhjen me rrjetin e energjise elektrike.
  - Skemat e matjes neto te energjise, garancia e origjines.
  - Biomasa dhe biokarburantet. Prodhuesit me përparësi
5. Ligji Nr. 68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”;
    - Produkti, etiketa, skeda informative dhe Përgjegjësitë e furnizuesve
    - Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut
    - Kundërvajtjet administrative dhe Ekzekutimi i vendimit
  6. Ligji Nr.116, datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave".
    - Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes për Llogaritjen e Performancës së Energjisë në Ndërtesa (PEN)
      - Kërkesat minimale (normat) të (PEN)
      - Llogaritja e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të (PEN)
      - Përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë. Ndërtesat me performancë “afër zero energji”
      - Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave. Të dhënat që duhet të përfshihen në “Certifikatën për performancën e energjisë”
      - Audituesit energjetikë për certifikimin e performancës së energjisë
      - Mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve të (PEN)
      - Detyrimet e subjekteve që kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesa, Kundërvajtjet administrative
- C. Menaxhimi i Energjisë dhe Auditit
1. Përkufizimet dhe Objektivat e Menaxhimit të Energjisë
  2. Përkufizimet e Auditimit të Energjisë dhe Nevojat për Auditim Energjetik
  3. Llojet e auditimeve Energjetike dhe Qasjet ligjore. Kostot e Energjisë
  4. Fazat e Auditimit. Performanca Energjetike
  5. Përputhja e Kërkesës për Energji me Përdorimin e saj
  6. Maksimizimi i Eficencës së Sistemeve Energjetike, optimizimi i Kërkesave Energjetike në Hyrje, zëvendësimi i Lëndëve Djegëse
  7. Instrumentat dhe Matjet për Auditin e Energjisë
  8. Specifikat Ligjore për Auditimin e Energjisë
- D. Bilanci Energjetik dhe i Lendeve djegëse
1. Hyrjet statistikore te domosdoshme
  2. Pjesët përbërëse të Bilancit Energjetik dhe lendeve djegëse. Principet bazë.
  3. Klasifikimi i Proceseve dhe Bilanci i Materialeve
  4. Bilanci Energjetik aktiv dhe pasiv
  5. Sistemet Energjetike dhe Analizat Energjetike
- E. Planet Energjetike te sistemeve te konsumit
1. Mbështetja e Niveleve të Larta Menaxhuese
  2. Përcaktimi i Profilit Energjetik dhe Përcaktimi i Skenarit Bazë
  3. Planifikimi dhe Politikat e Energjisë dhe Zbatim/Monitorimi i tyre
  4. Vlerësimi i Performancës Energjetike te konsumatorit te madh, Vlerësimi i Rezultateve.
  5. Mjetet e Menaxhimit për Zbatimin Eficent te Planeve
- F. Menaxhimi Financiar i Energjise
1. Nevoja për Investim, Vlerësimi dhe Kriteret
  2. Teknikat e Analizës Financiare, Cash Flow
  3. Analiza e Riskut
  4. Mundësitë e Financimit
  5. Kontraktimi i Eficencës së Energjisë dhe Roli i ESCO
  6. Zhvillimi i një Kontrate tipike ESCO
  7. Rast Studimor – Eficenca Energjisë në Ndërtesa Njëpërmjet ESCO
  8. Kontraktimi i Eficencës së Energjisë në Bashki njëpërmjet Kontraktimit të Performancës
- G. Menaxhimi i projekteve energjetike
1. Cfarë është një Projekt ne energji?

2. Cikli i Zhvillimit të një Projekti (PDC)
  3. Teknikat e Planifikimit të Projekteve
  4. Plani i Zbatimit për Nivelet e Larta Drejtuese
  5. Planifikimi i Buxhetit, Zbatimi dhe Monitorimi projekteve
  6. Matja dhe Verifikimi
- H. Objektivat dhe Monitorimi Energjistik
1. Cfarë janë Objektivat dhe Monitorimi ne sistemet konsumit te energjise
  2. Dizenjimi i Objektivave dhe Monitorimi tyre
  3. Elementët kyc të Sistemit të Objektivave dhe Monitorimit
  4. Burimet e të Dhënave dhe informacioneve
  5. Analiza e të Dhënave dhe Informacioneve
  6. Programet Kompjuterike te miratuara. Shembull - Energy Management Information System (EMIS)
- I. Energjia dhe Ndryshimet Klimatike
1. Energjia dhe Mjedisi. Cështjet Mjedisore Globale, Shiu Acid dhe Hollimi i Shtresës së Ozonit.
  2. Ngrohja Globale, Ndryshimet klimatike dhe Impakti i Ndryshimeve Klimatike
  3. Marrëveshjet ndërkombëtare UNFCCC (United Nations Framework Convention on climate Change)
  4. Marveshja e Parisit COP21. NDC per Shqiperine.
  5. NDC – Dokument Teknik dhe Ligji per miratimin ne Konvente. Objektivi shqiptar i NDC.
  6. Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Përpjekjet e Bashkimit Evropian për të Luftuar Ndryshimet klimatike
- J. Burimet e Reja dhe të Rinovueshme të Energjisë
1. Konceptet e Energjive të Reja dhe të Rinovueshme
  2. Energjia Hidrike per qellime te prodhimit te energjise Elektrike
  3. Bazat e Energjisë Diellore
  4. Energjia Diellore per qellime te prodhimit te energjise Termike
  5. Energjia Diellore per qellime te prodhimit te energjise Elektrike
  6. Energjia Eolike per qellime te prodhimit te energjise Elektrike
  7. Energjia nga Biomasa
  8. Energjia nga FUEL CELL
  9. Energjia nga Mbetjet
  10. Energjia nga Dallgët
  11. Energjia nga Baticat
  12. Energjia Gjeotermike.

## MODULI-II: EFIÇIENCA E ENERGJISË NË SHËRBIMET/PAJISJET TERMIKE

- I. Lëndët Djegëse dhe procesi i Djegies
  1. Vetitë kalorifike të Lëndëve Djegëse të Lëngshme
  2. Vetitë kalorifike të Qymyrit të gurit dhe biomasave drusore
  3. Vetitë kalorifike të Lëndëve Djegëse të Gazta
  4. Vetitë kalorifike të biomasave nga Mbetjet e Ngurta Urbane dhe në Agrikulture
  5. Procesi i Djegies
    - Djegia e Naftës
    - Djegia e Qymyrit
    - Djegia e Gazit
    - Djegia e Biomasës
    - Kontrolli i Djegies
- II. Gjeneratorët e Nxehtesise
  1. Sistemet e Kaldajave, Llojet dhe Klasifikimet
  2. Vlerësimi i Performancës (rendimentit) të një Kaldaje Tipike
  3. Trajtimi i Ujit të Kaldajave për qëllime të prodhimit të avullit të tejnxehur
  4. Shkarkimi i gazeve të djegies së Kaldajave
  5. Përmirësimi i Gadishmërisë së Kaldajave
  6. Ngrohësit (gjeneratorët) termik të Fluideve
  7. Mundësitë e Kursimit të Energjisë në Gjeneratorët e nxehtesise (kaldaja)
  8. Sistemet me Avulli
- III. Izolimi termik
  1. Qëllimi i Izolimit, Llojet dhe Aplikimi
  2. Llogaritja e Trashësisë së Izolimit
  3. Trashësia Ekonomike e Izolimit
  4. Formula të Thjeshtëzuara Për Llogaritjen e Humbjeve të Nxehtësisë
  5. Izolimi i Ftohtë, Materialet Rezistente ndaj Nxehtësisë
  6. Vetite termike të materialeve izoluese Rezistente Ndaj Nxehtësisë, Klasifikimi i tyre, Llojet tipike dhe Përdorimi në Industri. Përzgjedhja e materialeve izoluese
  7. Humbjet e Nxehtësisë nga Muret e Kaldajës
  8. Vetitë termike të Materialeve të ndertimit. Referenca në Metodologjinë Kombëtare të llogaritjes së PEN
- IV. Kogjenerimi dhe Kaldajat FCB (Fluidised Bed Combustion)
  1. Kogjenerimi.
    - Nevoja për Kogjenerim, Parimet e Kogjenerimit dhe Mundësitë teknike për aplikim
    - Klasifikimi i Sistemeve të Kogjenerimit dhe Faktorët që ndikojnë në Kogjenerim
    - Parametrat e Rendësishëm Teknik të Kogjenerimit dhe Faktorët Kryesor për Përzgjedhjen e sistemit të Kogjenerimit
    - Parametrat Tipik të Performancës së Kogjeneratorëve
    - Avantazhet e Sistemeve të Kogjenerimit
    - Eficenca e Turbinave me Avull
    - Përcaktimi i Eficencës së Kogjenerimit
    - Trigjenerimi
  2. Kaldajat FCB
    - Mekanizmat e Funksionimit dhe Tipat e Kaldajave FCB
    - Aplikimi i Boilerëve FCB me Biomasa
    - Mikroturbinat
- V. Rekuperimi i Nxehtësisë
  1. Klasifikimi dhe Aplikimet
  2. Avantazhet e Rekuperimit të Nxehtësisë
  3. Zhvillimi i një Sistemi të Rekuperimit të Nxehtësisë
  4. Pajisjet e tregut të Rekuperimit të Nxehtësisë
  5. Rikuperimi i nxehtesise në sistemet e ventilimit në ndertesa

- VI. Këmbyesit e Nxehtësisë
  - 1. Bazat e transmetimit të Nxehtësisë
  - 2. Konceptet e Këmbyesit
  - 3. Llojet e Këmbyesve (sipas Rrjedhës)
  - 4. Llojet e Këmbyesve (sipas Ndërtimit të Këmbyesit)
  - 5. Llojet e Këmbyesve (Sipas Aplikimit)
  - 6. Analizat e Eficencës së Energjisë
- VII. ANEKS Listat e protokollit për kontrollin e Eficencës së Energjisë në Pajisjet Termike

## MODULI-III: EFIÇIENCA E ENERGJISË NË SHËRBIMET/PAJISJET QE KONSUMOJNE ENERGJI ELEKTRIKE

- a) Sistemet Elektrike
  - 1. Njohja me Sistemet e Furnizimit të Energjisë Elektrike
  - 2. Faturimi i Energjisë Elektrike
  - 3. Menaxhimi i Ngarkesës Elektrike dhe Kontrolli i Kërkesës Maksimale ne pik.
  - 4. Përmirësimi i Fakorit të Fuqisë dhe Përfitimet
  - 5. Transformatorët
  - 6. Humbjet në Shpërndarje në Sistemet Industriale
  - 7. Vlerësimi i Humbjeve të Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sistemet Energjitike
  - 8. Përcaktimi i Humbjeve Teknike në Sistemin e Shpërndarjes
  - 9. Menaxhimi i Kërkesës (Demand Side Management)
  - 10. Harmonikat
  - 11. Analiza e Sistemeve të Energjisë Elektrike
- b) Motorrët Elektrike
  - 1. Llojet e Karakteristikat e Motorrëve
  - 2. Eficenca e Motorrëve dhe Përzgjedhja e tyre. Motorrët Eficentë
  - 3. Faktorët që Ndikojnë në Eficencën Energjitike dhe Minimizimi i Humbjeve gjatë Operimit
  - 4. Efektet e Ri-Avolzhimit në Eficencën e Energjisë
  - 5. Kontrolli i Shpejtësisë në Motorrët me Induksion AC
  - 6. Etiketimet e Eficencës së Energjisë në Motorrët eficient me Induksion.
- c) Sistemet e Ajrit të Kompresuar
  - 1. Llojet e Kompresorëve, Performanca e kompresorëve
  - 2. Komponentët e Sistemeve të Ajrit të Kompresuar dhe Operimi me Eficencë i ketyre Sistemeve. Vlerësimi i Kapacitetit të Kompresorit
  - 3. Listat e protokollit per kontrollin e Eficencës së Energjisë në Sistemet e Ajrit të Kompresuar
- d) HVAC dhe Sistemet e Ftohjes
  - 1. Tipet e Sistemeve te Ftohjes.
  - 2. Llojet e Kompresorëve dhe Aplikimet. Ftohësit e Tipik dhe Karakteristikat
    - Diagramat Psikometrike dhe Sistemi i Ajrit të Kondicionuar
    - Zgjedhja e një sistemi të Përshtatshëm Ftohje
    - Vlerësimi i Performancës së Impjanteve të Ftohjes
    - Faktorët që Ndikojnë në Performancë dhe Eficencë të Impjanteve të Ftohjes
    - Vlerësimi i Performancës i Njësive të Ajrit të Kondicionuar të llojeve të ndryshme
    - Sistemmet e Ruajtjes së Ftohjes
  - 3. Pompat e Nxehtësisë dhe Aplikimet
  - 4. Sistemet e Ventilimit
  - 5. Sistemet e Ngrirjes
  - 6. Sistemet e Lagështimit
  - 7. Standartet dhe Etiketimi i Sistemeve të Ajrit të Kondicionuar në Ndertesa
  - 8. Mundësitë e Kursimit të Energjisë
- e) Ventilatorët dhe Fryrësit
  - 1. Llojet e Ventilatorëve
  - 2. Vlerësimi i Performancës së Ventilatorit dhe Operimi Eficent i Sistemit
  - 3. Llojet e Ventilatorëve dhe Kriteret e Përzgjedhjes. Kontrolli i Rrjedhës
  - 4. Llogaritja e e Performancës së Ventilatorit
  - 5. Mundësitë e Kursimit të Energjisë
  - 6. Rast Studimor mbi Rënien e Presionit në Filtra
- f) Pompat e fluideve te lengshem dhe Sistemet e Pompimit
  - 1. Llojet e Pompave. Karakteristika e Pompes. Kurbat e Funkionimit
  - 2. Faktorët që Ndikojnë në Performancën e Pompokës
  - 3. Operimi Eficenti i Sistemeve të pompimit. Kontrolli i Rrjedhës
  - 4. Pompat e qarkullimit te ujit në Kaldaja

5. Sistemet e Pompimit të ujsellsave te bashkive
  6. Pompat e Ujit të Ujërave të Ndotura urbane
  7. Sistemet e Pompimit në Agrikulturë
  8. Mundësitë e Kursimit të Energjisë në Sistemet e Pompimit
- g) Sistemet e Ndricimit
1. Pramtrat Bazë të Ndricimit
  2. Burimet e Ndricimit dhe Llojet e Llampave
  3. Nivelet e rekomanduara të Ndricimit për Aktivitete të Ndryshme
  4. Metodot e Llogaritjes së Ndricimit- Projektimi i Ndricimit për ambientet e Brendshme
  5. Mundësitë e Përgjithshme të Kursimit të Energjisë
  6. Kontrollat Eficente të Ndricimit
  7. Standartet dhe Efektimet e Llampave FTL
  8. Rast Studimor
- h) Eficenca e sistemeve teknike në Ndërtesa
1. Pëcaktimet Ligjore. Kodi Energjistik i banesave
  2. Mbështjellja e Ndërtesës
  3. Sistemet teknike ne ndërtesa. (HVAC)
    - Uji i Ngrohtë Sanitar
    - Ndricimi
    - Ventilimi
    - Ngrohja
    - Ftohja
  4. Energjia e lendeve djegese dhe energjia Elektrike qe konsumohet per sistemet teknike
  5. Sistemet e pompimit të ujit ne Ndërtesës
  6. Furnizimi me Energji të Pandërprerë
  7. Sistemet e Menaxhimit të Ndërtesës (BMS)
  8. Klasifikimi i Ndërtesave sipas Eficencës
  9. Masat e Eficencës në Ndërtesa
- i) ANEKS : Listat e protokollit për Eficencën e energjisë në Pajisjet Elektrike.



## **MODULI 4: AUDITIMI I ENERGJISË PËR SISTEMET E PAJISJEVE DHE SHËRBIMEVE NË NDËRTESEA DHE INDUSTRI (MODUL VETEM PËR AUDITUESIT)**

### **A. Tema të përbashkëta për audituesit energjetik**

1. Përgatitja për auditimin e energjisë.
  - a. Përcaktimi i qëllimit të auditit.
  - b. Krijimi i një plani të auditit.
  - c. Përgatitja e listës për tu audituar.
  - d. Kqyrja dhe studimi paraprak i objektit.
  - e. Mbledhja e faturave të energjisë.
  - f. Analiza paraprake energjetike.
  - g. Bilanci fillestar i energjisë.
  - h. Llogaritjen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
2. Analiza e faturave të energjisë.
  - a. Faturat e energjisë elektrike.
  - b. Faturat e gazit.
  - c. Faturat e naftës.
  - d. Faturat e çdo lënde djegëse tjetër.
  - e. Analiza grafike e konsumit historik.
3. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.
  - a. Inventari i ngarkesës energjetike.
  - b. Përcaktimi i flukseve (rrymave) të energjisë.
  - c. Matja e ngarkesave në mororrat elektrike
4. Analiza e Kost-Benefitit për masat e efencës.
  - a. Analiza LCCA (Life-cycle cost analysis)
  - b. Metoda LCC (Life cycle cost).
  - c. Metoda NPV (Net present value).
  - d. Metoda IRR (Internal rate of return).
  - e. Periudha e thjeshte te vetshlyerjes SPP (Simple payback period).
5. Hartimi i raportit të auditimit dhe potencialet e mundshme të kursimit.
6. Hartimi i një plani veprimi për zbatimin e masave të efencës.
7. Deklarimet e kursimeve të energjisë dhe ekuivalenca me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
8. Analiza teknike-ekonomike e investimeve për masat e parashikuara.
9. Bazat energjetike dhe performanca e energjisë në teknologjitë tradicionale dhe inovative;
10. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik të:
  - a. Sistemeve teknike të reja;
  - b. Sistemeve teknike ekzistuese
11. Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike.
12. Qëllimi i auditimit dhe shembuj praktikë.
13. Skenarët energjetikë dhe bilancet energjetike; Analiza tekniko ekonomike e ndërhyrjeve dhe vlerësimi i potencialeve të kursimit të energjisë.
14. Energjia dhe transformimet e saj. Rekomandime për ndërhyrjet energjetike. Kostot optimale të ndërhyrjeve
15. Eficenca e energjisë dhe mbrojtja e mjedisit.

### **B. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në NDËRTESEA**

1. Procedurat për çertifikimin energjetik të ndërtesave sipas Ligjit për PEN.
2. Standartet dhe rregulloret teknike në fushën e konsumit të energjisë në ndërtesa.
3. Detyrimet dhe përgjegjësitë e çertifikuesit.
4. Konsumi i energjise ne Sistemet teknike të ndërtesave rezidenciale (Ngrohja, Ventilimi, Kondicionimi, Ndriçimi, Uji ngrohtë, Gatimi, Larja)

5. Bilanci i energjisë së sistemit të ndërtimit (mbeshtjellja dhe sisteme teknike). Auditimi i konsumit dhe analiza energjetike.
6. Llogaritja e performancës energjetike të ndërtesave dhe metodologjia.
7. Analiza e ndjeshmërisë për variablat kryesorë që të ndikojë në kostot energjetike.
8. Analiza teknike-ekonomike e investimeve në ndërtesë.
9. Njohja e burimeve energjetike dhe transformimi i tyre në ndërtesë.
10. Mbeshtjella izoluese e Ndërtimit:
  - a. Llojet dhe performanca e energjisë së elementëve të ndërtimit;
  - b. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.
11. Impiantet termike në ndërtesa:
  - a. Teknologjitë tradicionale dhe inovative në ndërtesa;
  - b. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik për sistemet teknike të reja dhe atyre ekzistuese.
  - c. Adoptimet për të rinovuar teknologjitë në ndërtesa.
  - d. Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike të ndërtesës.
  - e. Komforti termik në ndërtesë dhe normat e komfortit.
  - f. Ventilimi natyral dhe mekanik. Rekuperatorët e energjisë.
12. Menaxhimi i energjisë së ndërtesës dhe sistemeve teknike të saj.
13. Njohja e fushëveprimit të konsumit të energjisë në sistemet Rezidenciale dhe Shërbimet.
14. Auditimi i energjisë së ndërtesave. Kriteret e auditimit dhe kërkesat më të domosdoshme për auditim.
15. Përdorimi praktik i instrumentave matës të nevojshëm për të marrë të dhëna reale për procese të inspektimit dhe auditimit.
16. Konsumi i energjisë në banesë dhe bilanci auditues.

### **C. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në objektet dhe/ose instalimet industriale**

1. Eficenca e energjisë në pajisje dhe sisteme utilitare kryesisht në Industri. Njohuri të mjaftueshme në konsumin e energjisë në sistemet industriale.
2. Raporti i auditimit dhe potencialet e efikasitetit të energjisë në Industri.
3. Përpilimi i një raporti auditimi në ndërmarrjen industriale.
4. Rekuperuesit e energjisë në kaldaja.
5. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.
  - a. Inventari i ngarkesës elektrike
  - b. Inventari i përdorimit të energjisë termike
  - c. Kërkesa specifike sipas sistemeve
  - d. Balanca e energjisë
  - e. Sasia e shkarkimeve me efekt serrë.
6. Analiza e përdorimit të energjisë dhe skemat e prodhimit.
  - a. Profili i Ngarkesës/Kërkesës
  - b. Skemat e dinamikës së prodhimit të energjisë
  - c. Interpretimi i skemave të prodhimit të energjisë.
7. Identifikimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe të reduktimit të kostove.
  - a. Metodat direkte dhe indirekte të testimit të performancës.
  - b. Kontrolli i kërkesës për energji elektrike
  - c. Masa të kursimit të energjisë sipas sistemeve.
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Motorët elektrikë.
    - Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e Ajrit të Kompresuar
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Pompimit
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Ventilimit
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet e Ndriçimit
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Sistemet me Avull.
    - Mundësi të kursimit të energjisë në Proçeset e Ngrohjes.

- Mundësi të kursimeve të energjisë sipas sektorëve specifik.
8. Instrumentat e Auditimit të Energjisë në Industri.
    - Çështjet e sigurisë gjatë auditimit
    - Matësit e parametrave elektrikë
    - Matësit e temperaturës
    - Matësit e rrjedhës në tuba
    - Matësit e gazeve të çliruar
    - Matësit e shpejtësisë së rrotullimit
  9. Njohja e proceseve të përpunimit të lëndëve të para të ndërtimit dhe nevoja për energji të sistemeve industriale të prodhimit
    - Industria e Çimentos
    - Mundësi të kursimit të energjisë në industri specifike
    - Industria e Hekurit dhe Çelikut
    - Industria Tekstile
    - Industria e Kimike e Naftës dhe Nënprodukteve
    - Industria e Qelqit
    - Industria e përpunimit të Frutave dhe Perimeve.
    - Sistemet e përpunimit dhe trajtimit të ujrave urbane
    - Aktivitete të tjera industriale të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimet klimaterike.
  10. Matja e performancës në sistemet teknike industriale:
    - Sistemet e Kogjenerimit
    - Këmbyesit e Nxehtësisë
    - Motorët Elektrik dhe Motorët me Shpejtësi të Ndryshueshme (Variable Speed Drive)
    - Ventilatorët dhe Fryrësit
    - Pompat
    - Kompresorët
    - Impjantet e gjenerimit termik